

NJOFTIM

Për kandidatët që do të testohen për pozicionin e punës:

Inspektor i Kontrollit të Shërbimeve Postare dhe Regjistrarëve të *domain.al*

Procedura: LËVIZJE PARALELE BRENDA SË NJEJTËS KATEGORI

Në zbatim të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar si dhe VKM nr. 242, datë 18/03/2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese" i ndryshuar, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), njofton se:

- **Znj. Ilda Nesturi** do të vazhdojë konkurimin në procedurën e lëvizjes paralele brenda së njëjtës kategori.

Konkurimi:

- **Intervista me gojë** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (Salla e Mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, në datën **01.10.2021, ora 12:00**.

Kandidatët do të vlerësohen nga **Komiteti i Pranimit për Lëvizje Paralele (KPLP)**, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- 40** pikë për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë në: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnime dhe kualifikime në fushën përkatëse, si dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë, në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer.
- 60** pikë për intervistën e strukturuar me gojë.

Komiteti, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin **Inspektor i Kontrollit të Shërbimeve Postare dhe Regjistrarëve të *domain.al***.

Në rast se rezultojnë fitues më shumë se një kandidat, me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikeës 23, Kreu II të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese" i ndryshuar.

Lista e fituesve me mbi 70 pikë (mbi70%) do të njoftohet në datën **01.10.2021**.

Njoftimi fituesit do të publikohet: në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në faqen zyrtare të AKEP në datën **07.10.2021**.

Njesia Përgjegjëse / Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)